




ANEKS KONTRATA

Date 19.10.2020

Nr. Ref. 632-20-6023-2-2-5;
632-20-096-215

Në mes të

Komuna e Gjakovës - Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues)

Dhe

Roza Komani B.I. (N.N.SH. "Korben") - Gjakovë, me nr.unik 811129726 e përfaqësuar nga z.Ndue Komani (në tekstin e mëtejme Kontraktuesi), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontrate .

Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: **"Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës nr. i prokurimit- 632-20-3720-2-1-5, nr. i brendshëm-632-20-049-215, e dt.22.07.2020, e cila kontratë është në realizim e sipër.**


- i. Duke u bazuar në kërkesën për kryerjen e shërbimeve shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e këtyre shërbimeve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e shërbimeve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të shërbimeve për **Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi** pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e shërbimeve shtesë, sipas ofertës së datës 09.10.2020, me kushte të njëjta si në kontratën bazë.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e shërbimeve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. Planin dinamik për kryerjen e shërbimeve është **30 ditë**,
3. Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit prej **10%** të vlerës së kontraktuar për **60 ditë**.
4. Çmimi i shërbimeve shtesë është gjithsej: **41,852.25€ (katërdhjetë e njëmijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy euro e njëzetë e pesë cent)** sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. **632-20-6023-2-2-5**.

5. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e shërbimeve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
6. Pagesa e shërbimeve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas përfundimit të punëve.
7. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i shërbimeve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për shërbimet shtesë.
8. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktuesin		Për Kontraktuesin	
Emri:	z.Faton Gutaj	Emri:	z.Ndue Komani
Pozita:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	19.10.2020	Data:	19.10.2020
Vula:		Vula:	

**Bartja e mbeturinave nga stacioni transferues i mbeturinave në Gjakovë deri në deponinë
Regjionale në Landovicë**

Paramasa dhe Paralogaria

	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Çmimi/Njësi me TVSH (3)	Gjithsej totali me tv
1	Ngarkimi me eskavator ("bager") i mbeturinave, patrimi i terenit në stacionin transferues të mbeturinave në Gjakovë dhe transporti i tyre deri në deponinë Regjionale Landovicë. Distanca 30 km vajtje dhe 30 km ardhje (total 60km). Llogaritja në ton. Pesha e matur në deponi regjionale duhet të dëshmohet.	ton	4405.5	9.50 €	41,852.25 €
TOTALI me TVSH:					41,852.25 €



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	27.08.2020
NGA:	Milot Roka – Menaxher i Kontratës
PËR:	Z. Faton Gutaj – Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit Z. Ardian Gjini – Kryetar I Komunës
Titulli i Kontratës:	“ Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës”
CC:	Z. Shkumbin Kastrati – Drejtor i DSHP- së Komisioni i pranimi “ Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës” me Nr. të prokurimit -632-20-3720-2-1-5 dhe Nr. Të brendshëm – 632-20-049-215
Lënda:	Përgjigje në kërkesë për punët shtesë, të datës 24/08/2020

Fillimisht më lejoni të ju njoftoj që punimet projektit me titull “ Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës” me Nr. të prokurimit -632-20-3720-2-1-5 dhe Nr. Të brendshëm – 632-20-049-215 e cila është duke u realizuar nga Kompania N.N.SH. “Korben” (emri i biznesit Roza Komoni B.I.) – Gjakovë, me nr. Unik 811129726 i përfaqësuar nga Z.Ndue Komoni, me vlerë 420.000,00 €. me datë 24/08/2020 ka bërë një kërkesë për punë shtesë.

Bazuar në kërkesën e punë kryesit të dates 24/08/2020, ka kërkuar punë shtesë duke e njoftuar Komisionin për mbikqyrje dhe menaxherin e Kontratës. Komisioni I pranimi iu është përgjigjur kërkësës së dates 24/08/2020 duke I arsyetuar punimet sipas tabelarit të sjellur nga Operatorit Ekonomik. Pas aprovimit të komisionit të pranimi , po ju përcjell parallogarin e nevojshme për aprovimin e punëve shtesë.

Sipas parallogaritjeve del se vlera e këtyre punëve shtesë është 41.852,25 €.

KOMUNA E GJAKOVËS

**NJOFTIM PËR KOMISIONIN RREGULLTIVE TË
PROKURIMIT PUBLIK**

Sipas Nenit 35.1 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092



Për	Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik
Përmes	Ardian Gjini
Nga	Faton Gutaj
Lënda	Njoftim për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë
Titulli i aktivitetit të prokurimit	Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës
	632-20-6023-2-2-5
	632-20-096-215
Data	02.10.2020

Sipas nenit 35.2 të LPP, autoriteti kontraktues, pa ndonjë qëllim për të diskriminuar kundër apo në favor të ndonjë operatori ekonomik, ka përdorur Procedurën e Negociuar pa publikim të Njoftimit për Kontratë. Arsyeja për marrjen e këtij vendimi:

Neni 35.2.4(ii): punë apo shërbime të reja të përbëra nga përsëritja e punëve ose shërbimeve të ngjashme të besuara te operatori ekonomik të cili i ishte dhënë kontrata origjinale nga autoriteti kontraktues

SHPJEGIM

[Ofro shpjegim të detajuar për arsyet dhe faktorët të cilët janë marrë parasysh në marrjen e vendimit për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë]

Fillimisht më lejoni të njoftoj që punimet projektit me titull "Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës me nr. të prokurimit-632-20-3720-2-1-5 dhe nr. të brendshëm-632-20-049-2-1-5 e cila është realizuar nga Kompania N.N.SH. Korben (emri i biznesit Roza Komani B.I.)-Gjakovë me nr Unik 811129726 i përfaqësuar nga Z.Ndue Komani, me vlerë 420.000,00€. me datë 24.08.2020 ka bërë n kërkesë për punë shtesë.

INFORMATË SHITESË:

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka të drejtë të kërkojë çdo informata shtesë të nevojshme nga Autoriteti Kontraktues

Zyrtari i Prokurimit: *Faton Gutaj*

Nënshkrimi:

Informatat kontaktuese:

Tel: 038-200-44041

E-mail: faton.gutaj@rks-gov.net

Faksi:



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për Komuna e Gjakovës
(në bazën "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: N.A. SH. Korben, Fsh. Guskë-Gjakovë Gjakovë
(në bazën "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: TRAITIMI I DEPONISE TRANSFER NE KOMUNEN E GJAKOVES

Numri i Prokurimit: 632-20-096-225

Garancion me kërkesë të parë

Duke qenë operator ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

Duke qenë operator ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

Duke qenë operator ekonomik pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

Autoriteti Kontraktues nënshkruar, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik deri në një total prej: **Kater mije e Nje qinde e Tetedhjete e Pes e Njzet e Tre 4,185.23 €** zotërimi i kësaj shume, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet e vijimit:

a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmimeve të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetur pa u përmbushur shumë numërore, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Garancia e kësaj shume limituar prej: **4,185.23 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që mundet pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kësaj garancie i jepet vlerë 60 ditë prej **19.10.2020** deri më **18.12.2020**

Garancia do të anulohet në mënyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" deri më datën e shënuar më lartë.

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.

Rr.Sylejman Vokshi, Pallati i kuq L-B nr.1, Prishtinë

Data

19.10.2020